

DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS
Zyra e Shefit Akademik
440 N. Broad Street, Suite 210
Philadelphia, PA 19130

Penny Nixon
Shef Akademik

Tel. Zyrë: 215.400.4200
Faks: 215.400.4201

26 Nëntor 2012


Të dashur Prindër dhe Kujdestarë,

Drejtoria Arsimore e Filadelfias këtë vit shkollor, është në procesin e zëvendësimit të Provimeve PSSA, me Provime të autorizuara nga shteti "Keystone". Këto provime janë në një linjë me Standardet e Reja për Lëndët Bazë dhe do të vlerësojë aftësitë e nxënësve të klasave të 11^{ta} në lëndët Algjebra 1, Letërsi dhe Biologji. Këto teste do të zhvillohen në Janar 2013. Në vazhdim, ndonjë nxënës, jo nga klasat e 11^{ta}, që ka përfunduar Algjebërën 1, English II, dhe/ose Biologji, gjithashtu do të marrë pjesë në Provimet Keystone, në të njëjtën kohë si edhe nxënësit e tjerë të klasave të 11^{ta}. Nëse ata e kalojnë provimin, nuk do të jetë e nevojshme për ta që të bëjnë testin përsëri kur të jenë në klasën e 11^{te}. Çdo nxënës që nuk arrin rezultatet I Aftë (Proficient) ose I Avancuar (Advanced), në ndonjë nga seksionet e provimit, do të ribëjë testin përsëri, në Maj 2013. Të gjithë nxënësit që janë përfshirë në shtator në Anglisht II (English II), Algjebra 1 (Algebra 1) dhe Biologji (Biology) do të bëjnë Provimin Keystone në Maj 2013.

Ju dhe fëmija juaj duhet ta keni parasysh se nuk do të ketë kufizim kohe në këtë provim, kështu që secili nxënës do të ketë të gjithë kohën e nevojshme në ditën e provimit. Provimet do të përbëhen nga pyetje që kërkojnë përgjigje me zgjedhje (multiple choice); (60-75% e testit) dhe pyetje që kërkojnë formulim të përgjigjes (constructed response); (25-45% e testit). Shumica e nxënësve do të bëjnë provimin me laps dhe letër; megjithatë një numër shumë i kufizuar mund ta bëjnë provimin online.

Falaminderit shumë për mbështetjen e vazhdueshme në synimet tona për të ndihmuar që çdo fëmijë të vazhdojë rrugën për të arritur maksimumin e mundësive të tij.

Sinqerisht,



Penny Nixon

Për informacione dhe dokumenta të tjerë të përkthyer në Gjuhën Shqipe, ju lutemi vizitoni uebsajtin:

www.philasd.org/language/albanian